



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Nr. llog. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 03-02/3571/17
 Prot. No. _____
 Data _____
 Datum 30-10-2017
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2514/17, për z. Arber Rexhaj, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Arber Rexhaj, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Rexhaj është njoftuar me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se brenda afatin ligjor do të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare e lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3400/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat N.Sh.Shtëpia Botuese "Triniagu". Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

